

Kjo gazetë, është një publikim tremujor që pasqyron aktivitetet e Qendrës Kombëtare Burimore dhe zhvillimet më të fundit në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri, mundësitë për financim, rritje kapaciteteve dhe rrjetëzimit për OShC-të si dhe informacione të tjera relevante nga rajoni e më gjerë.

NË KËTË EDICION

AKTIVITETET E QKB-SË



Event Rrjetëzimi "Vullnetarizmi & Solidariteti -Praktika, sfida dhe zhvillime të ardhshme"

Adresimi i problematikave mbi projektligjin "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse"

Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2019

Opinion mbi Projektligjin "Për regjistrin qendror të llogarive bankare" dhe ndikimin në organizatat e shoqërisë civile

Mbi Vullnetarizmin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij në Shqipëri

Fushatë advokacie e shoqërisë civile në mbrojtje të Pyllit të Sodës - Zyra Rajonale Vlorë

Tryeza diskutimi me organizata të shoqërisë civile në Rajonin e Veriut - Zyra Rajonale Shkodër

Aktivite nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Kodi i Standardeve për OShC-të

Shkëmbim eksperiencë mes Qendrave Burimore mbi mekanizma të përmirësimit të standardeve të OSHC-ve

Festojmë së bashku - Llogaridhënia Globale #GAW2020

Akademia e OJF-ve

Programe Trajnimi për OShC-të

Sesione informuese me OShC-të mbi procesin e anëtarësimit në BE

Zgjidhen anëtarët e rinj në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSCh)

Deklaratë e një grupi organizatash të shoqërisë civile mbi projektligjet e Paketës Anti-shpifje

Njoftim për përditësim në e-filing të të dhënave të adresave të tatimpaguesve

Organizatave e shoqërisë civile mbështesin grevistët e punonjësit në Rafinerinë Ballsh

Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)

Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian zhvilloi mbledhjen e radhës

Takim për koordinim e rritje të bashkëpunimit mes TACSO 3 dhe Qendrave Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi

EU TACSO publikon Raportin e Vlerësimit të Gjendjes së Mjedisit Mundësues dhe Kapaciteteve të Shoqërisë Civile për periudhën 2018-2019

Komisioni Evropian ka publikuar Paketën e Zgjerimit 2020

THIRRJE DHE MUNDËSI



Thirrje

Njoftime



163 pjesëmarrës



4 takime me institucionet









1 Qendrim I hapur



3 takime online me OShC-të



1 Studim i zhvilluar mbi Status Quo për vullnetarizmin në Shqipëri



Event Rrjetëzimi "Vullnetarizmi & Solidariteti -Praktika, sfida dhe zhvillime të ardhshme"

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile (NRC) në bashkëpunim me Shoqatën Përtej Barrierave (BBA) organizuan më 23 dhe 24 korrik 2020 Eventin e Rrjetëzimit "Vullnetarizmi dhe Solidariteti - Praktika, sfida dhe zhvillime të ardhshme".

Aktiviteti vjen në vijim të punës disa mujore të Përtej Barrierave dhe Qendrës Kombëtare Burimore për identifikimin dhe vlerësimin e problematikave dhe sfidave që organizatat dhe grupet informale ndeshin gjatë zbatimit të kuadrit ligjor për vullnetarizmin.

Eventi dy-ditor i organizuar online, mbledhi rreth 163 pjesëmarrës nga organizata rinore, aktivistë, donatorë dhe institucione publike, në katër panele diskutimi mbi çështje të rëndësishme si: Kuadri ligjor, politikat, praktika dhe sfida të vullnetarizmit në BE dhe vendet e Ballkanit Perëndimor; kuadri ligjor, politikat dhe strukturat për zbatimin e tyre në Shqipëri; Praktika të Vullnetarizmit dhe Solidaritetit të Organizatave të Shoqërisë Civile në vend; Mbështetja dhe nxitja e vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive.

Pjesë e një serie aktivitetesh për këtë çështje, ky event kontribuon në debatin për zhvillimin e mëtejshëm të vullnetarizmit në Shqipëri, duke sjellë një panoramë të kuadrit ligjor dhe rregullator të vullnetarizmit në vend, në vendet e rajonit dhe disa vende të Bashkimit Evropian.

Aktiviteti krijoi mundësi rrjetëzimi për OShC-të dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse, duke u ofruar mundësinë për të gjeneruar kontakte, prezantuar punën e tyre si dhe diskutuar konkretisht për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit të të gjithë aktorëve dhe grupeve të interesit në krijimin e një mjedisi mundësues mbi këtë çështje. [Lexo më shumë rreth eventit dhe diskutimeve në panele.](#)

Së shpejti!

Ruani datën 4 dhjetor 2020

Konferencë Kombëtare e Shoqërisë Civile në Shqipëri 2020

APLIKO Për të organizuar një workshop




Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Adresimi i problematikave mbi projektligjin “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”



Në vijim të angazhimit për lehtësimin e procesit të konsultimit me sektorin për Projekt Ligjin "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", NRC organizoi një takim me donatorë dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare në vend. Takimi erdhi edhe në përgjigje të interesit të madh të këtyre institucioneve lidhur me projekt ligjin dhe reagimin e organizatave të shoqërisë civile, për t'u njohur më nga afër me çështjet problematike identifikuar nga OShC-të dhe rekomandimet e tyre. Ata shprehën mbështetjen e tyre për organizatat dhe këtë çështje, duke e konsideruar si shumë të rëndësishme për mjedisin mundësues të avancimit të shoqërisë civile.

Projekt ligji është tashmë në procedurë në Parlament. Pavarësisht adresimit të problemeve dhe paqartësive të projekt ligjit, nga organizatat e shoqërisë civile, që në fazën e mëparshme të konsultimit në një takim me Ministrinë e Drejtësisë, me keqardhje u konstatua që vetëm 15% e sugjerimeve ishin marrë parasysh në draft ligjin e dërguar për miratim në parlament.

Në këtë situatë dhe në vijim të takimit, grupi i OJF-ve, i`u drejtua përfaqësuesve të Kuvendit të Shqipërisë me një [kërkesë për organizimin e një seance dëgjimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile mbi projektligjin](#). Kjo seancë do të shërbejë për parashkrimin e të gjitha problematikave të identifikuara, rezervave dhe sugjerimeve të sektorit si dhe krijimin e mundësive për vendosjen e urave të vazhdueshme të komunikimit me qëllim që të gjitha këto probleme dhe sugjerime të nënshtrohen një debati të mirëfilltë parlamentar, dhënies së argumenteve reciproke dhe të bazuara në standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira. Kërkesa është pranuar nga ana e Kuvendit dhe ditët në vijim presim organizimin e seancës dëgjimore.



Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2019



Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri dhe Rrjeti Ballkanik Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile publikuan edicionin e shtatë të Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, duke mbuluar zhvillimet kryesore në Shqipëri, gjatë vitit 2019.

Ky raport është pjesë e një seri raportesh vendore që mbulojnë shtatë vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali e Zi, Serbia dhe Turqia.

Ndër gjetjet kryesore të raportit të monitorimit të 2019-ës veçojmë:

- Mungesa e një regjistri elektronik me të dhëna të plota për sektorin jo-fitimprurës, i cili do të mundësonte përdorimin e tyre nga institucionet publike dhe palët e tjera të interesuara.
 - Rritja e kontrollit të institucioneve shtetërore mbi veprimtarinë e OShC-ve, përmes miratimit të ligjeve mbi paketën e parandalimit të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit, të cilat çënojnë pavarësinë e sektorit.
 - Strategjitë dhe mekanizmat e krijuar për bashkëpunimin Shtet-OShC (Udhërrëfyesi dhe KKShC) nuk po japin rezultatet e pritura drejt një mjedisi mundësues për shoqërinë civile, për shkak të zbatimit të dobët dhe mungesës së reflektimit rreth problematikave të sektorit.
 - Edhe pse OShC-të janë ofruesit kryesorë të shërbimeve sociale, kontributi i tyre nuk njihet plotësisht nga shteti, dhe nuk mbështetet përmes një kuadri ligjor mundësues që do të lehtësonte funksionimin dhe aksesin e tyre në fondet shtetërore apo mbështetje të tjera jo – financiare.
- Për më shumë gjetje dhe rekomandime, [lexoni raportin e plotë](#).

Opinion mbi Projektligjin “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” dhe ndikimin në organizatat e shoqërisë civile



Përgjatë muajit tetor, organizatat e shoqërisë civile, midis ndryshimeve të tjera në kuadrin ligjor rregullator të veprimtarisë së sektorit, u njohën me iniciativën ligjore të qeverisë “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”. Ky projekt ligj është pjesë e një serie zhvillimesh ligjore që kanë ndodhur në këto 18 muajt të fundit, me efekt të drejtpërdrejtë në organizimin dhe funksionimin e sektorit, si pjesë e masave parandaluese për pastrimin e parasë.

Megjithë afatet e ngushta të konsultimit, një grup OJF-sh punuan për identifikimin e çështjeve më shqetësuese, për ti adresuar më pas pranë institucioneve përgjegjëse për hartimin e ligjit. Për këtë, një opinion mbi projektligjin dhe ndikimin që do të ketë në organizatat jofitimprurëse u hartua dhe u nda gjerësisht me të gjithë aktorët e rëndësishëm nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile. [Njihuni më shumë me Opinionin](#)

Mbi Vullnetarizmin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij në Shqipëri

Prej disa muajsh, Përtej Barrierave në bashkëpunim dhe me lehtësimin e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile kanë zhvilluar disa takime me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës për problematikën e ligjit dhe marrjen e informacioneve mbi procedurat dhe format për zbatimin e akteve ligjore. Në vijim të tjera diskutime dhe aktivitete do të organizohen në kuadër të zhvillimit të një mjedisi mundësues për vullnetarizmin në vend.

Fushatë advokacie e shoqërisë civile në mbrojtje të Pyllit të Sodës - Zyra Rajonale Vlorë



Gjatë muajit qershor një grup prej 11 organizatash të shoqërisë civile me iniciativë dhe koordinim të Zyrës Rajonale Vlorë të Qendrës Burimore për Shoqërinë Civile, zhvilluan një fushatë advokacie. Si pjesë e fushatës, u hartua një peticion në emër të 22 organizatave të shoqërisë civile drejtuar kryetarit të Bashkisë Vlorë, Këshillit Bashkiak Vlorë, Prefektit të Qarkut Vlorë, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, Këshillit të Qarkut Vlorë, si dhe për dijeni të gjithë anëtarëve të Komitetit të Menaxhimit të Peizazhit të Mbrojtur Vjosë – Nartë, duke kërkuar mbrojtjen e Pyllit të Sodës. Peticioni vjen në vijim të një sërë takimesh të OShC-ve me zyrtarët lokalë lehtësuar nga Zyra Rajonale Vlorë, si dhe një programi të dedikuar trajnimi, mentorimi dhe informimi mbi kuadrin ligjor dizajnura dhe organizuar nga Qendra. Në përgjigje të kërkesës të organizatave të shoqërisë civile u organizua një takim me Prefektin e Qarkut Vlorë, nënkryetarin e Bashkisë dhe një përfaqësi nga grupi i OShC-ve, në mbledhjen e Komisionit të Peticioneve të Këshillit Bashkiak Vlorë. Takimi shërbeu për të diskutuar mbi qëndrimin e organizatave. Tre çështjet e ngritura në peticion janë bërë pjesë e rekomandimeve të përcjella Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe AKZM nga Komiteti i Menaxhimit të Peizazhit të Mbrojtur Vjosë – Nartë, po ashtu edhe këshilltarët dhe kryetari i Bashkisë shprehën mbështetje për rehabilitimin sa më të shpejtë të Pyllit të Sodës duke vlerësuar kontributin e sektorit të shoqërisë civile.

Në vijim, Bashkia Vlorë filloi punën intensivisht për heqjen e pemëve gati për tu rrrëzuar që përbënin rrezik për jetën e qytetarëve. Grupi i OShC-ve nismëtare do të vazhdojë advokimin deri në përmbushjen e të gjitha pikave të peticionit.

AKTIVITETET E QKB

Tryeza diskutimi me organizata të shoqërisë civile në Rajonin e Veriut - Zyra Rajonale Shkodër

Zyra Rajonale Shkodër e Qendrës Burimore për Shoqërinë Civile ka zhvilluar një seri takimesh diskutimi me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Kukës, Malësi të Madhe (VIS Albania) dhe Koplik (Qendra Rinore ARKA).

Emergjencia Covid-19 e cila ka krijuar një seri sfidash dhe problematikash për punën e organizatave lokale në këtë rajon ishte fokusi i diskutimeve me OShC-të. Qëllimi i takimeve ishte eksplorimi i mënyrave dhe mundësive për mbështetjen e organizatave dhe komuniteteve lokale. Disa nga çështjet e trajtuara ishin nevoja për angazhimin dhe mobilizimin e të rinjve në jetën publike e sociale, aplikimet për grante për zhvillimin e jetës rurale dhe nevojën për shërbime publike më efçente si transport publik për rrugët rurale edhe në orët e pasdites të cilat duhet të përgjigjet bashkia Malësi e Madhe.


Zyra Rajonale Shkodër do të vazhdojë të ofrojë informacion, asistencë, mundësi rrjetëzimi, lehtësim procesesh advokuese dhe mobilizuese për gjitha organizatat e rajonit.



Aktivite nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri



Foto nga pjesëmarrja në mbledhjen online në Komisionin e Peticioneve të Bashkisë Vlorë me grupin e OJF-ve për çështjen e Pyllit të Sodës - **Zyra Rajonale Vlorë**



Qendra Burimore për Shoqërinë Civile Vlorë ka ofruar një seri shërbimesh help desk për OJF-të lokale, duke i mbështetur për shkrim projekt propozimesh si dhe pjesëmarrje në takime/trainime online të fushës së tyre të interesit - **Zyra Rajonale Vlorë**



Gjatë takimit me Forumin Civil të Selenicës për ngritjen e një fushatë advokacie mbi ndërtimin e dy kënde lojërash - **Zyra Rajonale Vlorë**



Shkodër

Aktivite nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Advokim dhe Dialog për Politikëbërje



Gjatë bisedës me Komisionerin për Diskriminimin mbi aktivitetet e NRC dhe mundësitë e bashkëpunimit - **Zyra Rajonale Shkodër**




Prezantimi i Qendrës gjatë eventit hapës së projektit "A strong youth a better future- YEOP Shkodra" - **Zyra Rajonale Shkodër**



Gjatë takimeve me përfaqësues të OShC-ve për të diskutuar mbi thirrjet për projekte gjatë muajit shtator - **Zyra Rajonale Shkodër**

Rritja e Transparencës dhe përgjegjshmërisë së OShC-ve

Kodi i Standardeve për OShC-të



Në vijim të procesit për hartimin e Kodit të Standardeve për OShC-të, Qendra Kombëtare Burimore ka organizuar gjatë këtyre muajve një seri takimesh rajonale online në të gjithë vendin për të prezantuar dhe promovuar gjerësisht Kodin e Standardeve për sektorin.


Rreth 100 drejtues e përfaqësues të OShC-ve, pjesëmarrës në këto takime, u njohën dhe dhanë mendimet e tyre mbi draftin e Kodit të Standardeve zhvilluar nga grupi nismëtar, mbi parimet dhe angazhimet e Kodit, strukturat zbatuese si dhe kornizën vlerësuese të përbushjes së kriterëve për anëtarësim në Kod.

Iniciativa vlerësohet si shumë e rëndësishme nga organizatat, duke theksuar më tej rëndësinë e ngritjes së një praktike të mirë e të unifikuar të vetëqeverisjes në sektor duke kontribuar kështu në qëndrueshmërinë e OShC-ve si dhe rritjen e besimit midis palëve të interesuara, bashkëpunëtorëve, donatorëve dhe publikut.

Qendra Kombëtare Burimore do të vijojë të promovojë gjerësisht nismën e Kodit të Standardeve dhe në muaj e ardhshëm, me një sërë takimesh dhe aktivitetet të dedikuara në mbarë vendin.

Nën lehtësimin e Qendrës e cila do të kryejë rolin e sekretariatit të Kodit të Standardeve, brenda 2020 do të finalizohen strukturat zbatuese të tij, duke i hapur rrugë anëtarësimin të OShC-ve në Kod.

Shkëmbim eksperience mes Qendrave Burimore mbi mekanizma të përmirësimit të standardeve të OSHC-ve



Në vijim të shkëmbimit të eksperiencave dhe aktiviteteve në rajon, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile zhvilloi një takim online me përfaqësuesit e Qendrës Burimore për Shoqërinë Civile në Turqi. Takimi vjen nën frymën e bashkëpunimit rajonal për ngritjen e praktikave të mira të vetëqeverisjes së shoqërisë civile që të jenë më efektive, të përgjegjshme dhe transparente, e që të rrisin besimin e publikut dhe përmirësojnë imazhin e sektorit.

Qendra Burimore ndau me kolegët nga Turqia eksperiencën e hartimit të Kodin e Standardeve të OShC-ve shqiptare, procesin, strukturat zbatuese dhe mekanizmin e vetëvlerësimit.

Kodi i Standardeve është një tërësi parimesh dhe angazhimesh se si OShC-të kryejnë punën e tyre dhe ndërmarrin veprime për përmirësimin e rezultateve të tyre. Përmirësimi i praktikave të tilla dhe promovimi i tyre është dhe do të vijojë të jetë në ndër qëllimet kryesore të Qendrës përgjatë punës së saj.

Rritja e Transparencës dhe përgjegjshmërisë së OShC-ve

#BeAccountable #GAW20

Festojmë së bashku - Llogaridhënia Globale #GAW2020

EXCHANGE ACTIVITIES (Times in GMT+2)		
October 12: Accountability in the Digital Age		9 AM
October 13: Civil Society Organisations' Accountability in times of COVID-19		2 PM
October 14: The Power of Stakeholder Engagement in Accountability Practices		3 PM
October 15: Accountability Self-Assessment Tools (Round Table Discussion)		1 PM
October 16: Post-pandemic: Legitimacy, Transparency and Accountability Best Practices		9 AM

Përgjatë datave 12-16 tetor, Partnerët Shqipëri dhe NRC i`u bashkua anëtarëve të Affinity Group of National Associations (AGNA), rrjetit të organizatave ombrellë nën organizimin e CIVICUS, në celebrimin e Javës së Llogaridhënies Globale #BeAccountable #GAW2020

Qëllimi i GAW është të promovojë llogaridhënien në sektorin e shoqërisë civile, nëpërmjet një sërë aktivitetesh online, për prezantimin me iniciativa të OShC-ve zbatuar në mbarë botën, mbi Transparencën dhe Llogaridhënien, të kuptuarit më tej të praktikave dhe mekanizmave të llogaridhënies si dhe të mësuarit më shumë rreth këtyre koncepteve. Qendra Burimore dhe Partnerët Shqipëri u bënë pjesë e disa aktivitetesh në kuadër të javës dhe ndanë eksperiencën si iniciatorë të nismës së hartimit të Kodit të Standardeve për OShC-të në Shqipëri, punën e bërë në këtë drejtim si dhe aktivitetet konsultuese dhe promovuese realizuar me sektorin.

AKTIVITETET E QKB

Fuqizim Kapacitetesh

Akademia e OJF-ve

Strategic Communication Academy 2020

#leksioni7
"Komunikimi strategjik"

Providing Public Support and Working with the Private Sector - Fundraising and Philanthropy Academy 2020


#leksioni9
"Sigurimi i mbështetjes publike dhe puna me sektorin privat - Ngritja e fondeve dhe filantropia"

Programi i Akademisë-së OJF-ve 2020 ka vijuar me të tjera leksione virtuale mbi Komunikimin strategjik, Krijimin dhe funksionimin e rrjeteve dhe koalicioneve, Sigurimin e mbështetjes publike dhe punën me sektorin privat - Ngritja e fondeve dhe filantropia, Qeverisjen me Pjesëmarrje dhe Advokim dhe Lobim, duke mbyllur kështu ciklin e leksioneve për këtë vit akademik. Lektorë me eksperiencë, ekspertë në secilën prej çështjeve të sipërpërmendura por edhe të ftuar të veçantë, kanë qenë pjesë e sesioneve.

#leksioni8
"Krijimi dhe funksionimi i rrjeteve dhe koalicioneve"

#leksioni10
"Qeverisja me pjesëmarrje"

#leksioni11
"Advokim & Lobim"



Znj. Diana Nokaj – Menaxhere e HUB në

Kosovaldeas, e ftuar në leksionin Ngritja e fondeve dhe filantropia ndau me akademistët informacion mbi Platformën e parë Crowdfunding në Kosovë për ngritjen e fondeve në fushën e artit dhe kulturës, angazhimit civil dhe qëndrueshmërisë të realizuara në dhe për Kosovën.



Znj. Ilina Neshikj, Drejtore Ekzekutive e

Rrjetit për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkan e ftuar speciale e leksionit për të ndarë përvojën e saj, sukseset dhe sfidat e hasura në menaxhimin e një rrjeti Ballkanik.




Gjithashtu për të ofruar dhe një këndvështrim lokal mbi sukseset dhe sfidat e hasura në ngritjen, forcimin dhe menaxhimin e një rrjeti OShC, në këtë leksion patëm kënaqësinë të kishim të ftuar Z. Andi Rabi, drejtues i Rrjetit "Youth Voice".

Akademia e OJF-ve



Asistencë dhe mentorim për pjesëmarrësit e Akademisë

Edhe në këto muaj, krahas leksioneve, si pjesë e Akademisë janë zhvilluar rreth 20 sesione mentorimi dhe këshillimi në grupe, me pjesëmarrësit e Akademisë, për t'i udhëzuar dhe ofruar asistencë të mëtejshme në përmirësimin e politikave dhe procedurave të brendshme të tyre organizative, shkrimin e projekt propozimeve, zhvillimin e planeve strategjike, planeve të komunikimit dhe të ngritjes së fondeve, si dhe njohjen e ndryshimeve më të fundit në kuadrin ligjor të organizatave jofitimprurëse duke kontribuar në përmirësimin e performancës së tyre, krijimin e standardeve të punës si dhe rritjes së qendrueshmërisë së tyre.





Nga sesionet e mentorimit me pjesëmarrësit e Akademisë

Programe Trajnimi për OShC-të



Qendra vijon ofrimin online të programeve të trajnimit të dedikuara për sektorin jofitimprurës, bazuar në nevojat e identifikuara përmes [Vlerësimit të nevojave të sektorit](#), zyra rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore, si dhe kërkesave të drejtpërdrejta nga OShC-të.



Rreth 160 përfaqësues të OShC-ve nga Vlora, Fieri, Saranda, Lushnja, Patosi, Berati, Kuçova, Ura Vajgurore, Elbasani dhe Tirana morën pjesë në trajnimet rajonale dhe rritën më tej


njohuritë e tyre në temat e: "Përdorimi i platformave të bashkëpunimit online", "Ngritja e Fondeve dhe Gjenerimi i të Ardhurave", "Advokaci dhe Lobim" dhe "Si të tregosh historinë tëndë nëpërmjet mjeteve kreative online-Storytelling".

Sesione informuese me OShC-të mbi procesin e anëtarësimit në BE

Lëvizja Evropiane në Shqipëri (EMA) si një nga partnerët implementues të projektit dhe në kuadër të komponentit për ngritjen e kapaciteteve organizoi një seri sesionesh informuese mbi Integrimin Evropian në Sarandë, Berat, Selenice, Fier, Vlorë, Tropojë, Malësinë e Madhe, Durrës, Kavajë dhe Krujë gjatë këtij muajve.

Rreth 40 përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile dhe aktorë lokalë u bashkuan në sesionet informuese për t'u informuar mbi historikun dhe momentet kryesore të procesit të Integritimit të Shqipërisë në BE, etapat e procesit dhe ku ndodhet Shqipëria krahasimisht me vendet e tjera të Rajonit, si dhe strukturat negociuese dhe mundësitë për përfshirje dhe angazhim më të madh të shoqërisë civile në këtë proces.

Këto sesione janë në vijim të një serie aktivitetesh të organizuara nga EMA në bashkëpunim me Qendrën, me qëllim rritjen e njohurive dhe njohjen e proceseve pjesëmarrëse dhe kontribuuese në procesin e anëtarësimit të vendit në BE.




Nga seancat informuese me OShC –të në Sarandë, Berat, Selenicë, Fier & Vlorë



12 Sesione informimi




105 Përfaqësues



Nga seancat informuese me OShC –të në Tropojë & Malësinë e Madhe.



12 Qarqe



Nga seancat informuese me OShC –të në Tiranë & Durrës

Zgjidhen anëtarët e rinj në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Në vijim të thirrjes për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të KKShC-së në shtator, shpalli listën emërore me katër anëtarët e zgjedhur nga organizatat e shoqërisë civile. Anëtarët e rinj të KKShC-së janë:

Për fushën e veprimit A "Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE"

- Dritan Sakuta - Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim (RIAS)
- Armando Bala - Vizioni i Ri 2016 / New Vision Organization

Për fushën e veprimit B "Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor"

- Ermelinda Mahmutaj - Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)

Për fushën e veprimit C "Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilesisë së jetes"

- Andi Rabiaj - Rrjeti i Organizatave "Zëri i të Rinjve"



Deklaratë e një grupi organizatash të shoqërisë civile mbi projektligjet e Paketës Anti-shpifje

Pas informimit për rikthimin e të ashtuquajturit Paketa Ligjore Anti-shpifje nga Presidenti për rishqyrtim në parlament, pesëmbëdhjetë organizata të shoqërisë civile me anë të një Letre të hapur, i kanë bërë thirrje Kuvendit të Shqipërisë, të rinisë procesin nga e para në mënyrë që një nismë e tillë ligjore të ndërmerret vetëm pasi të jetë siguruar respektimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe standardeve ndërkombëtare mbi lirinë e shprehjes. OShC-të parashtrajnë marrjen në konsideratë dhe adresimin e problematikave të ngritura në opinionin e Komisionit të Venecias mbi këtë çështje si dhe përfshirjen e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e mediave në proces.

Sjellim edhe njëherë në vëmendjen e sektorit që Kuvendi i Shqipërisë miratoi dhjetorin e vitit të kaluar mes protestave nga qytetarët dhe aktivistët e të drejtave të njeriut një ligj që krijon një kontroll administrativ të përmbajtjes së medias online. Për më shumë lexoni [Deklarata e OShC-ve](#) dhe [Opinionin i Komisionit të Venecias](#)

Njoftim për përditësim në e-filing të të dhënave të adresave të tatimpaguesve



Administrata Tatimore, bazuar në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore", i ndryshuar, neni 23, pika 1, si dhe të Ligjit nr.87/2019 "Për faturen dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", kërkon nga çdo subjekt tatimpagues që brenda datës 1 Nëntor 2020 të japin informacione të detajuara lidhur me çdo adresë apo vend ushtrimi biznesi të rregjistruar. Mosdhënia e këtij informacioni konsiderohet kundravajtje administrative.


Lexoni më shumë mbi procedurën [këtu](#)

Organizatave të shoqërisë civile mbështesin grevistët e punonjësit në Rafinerinë Ballsh

Përmes një letre të hapur drejtuar Kryeministrit dhe institucioneve të tjera shtetërore organizatat kërkojnë të respektohen dhe mbrohen të punësuarit e Rafinerisë së Ballshit, të dëgjohehen pretendimet e tyre si dhe të merren masa të menjëhershme për zgjidhjen e kërkesave. [Lexoni më shumë rreth letrës](#)



Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)



Me 2 shtator 2020, me propozim të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Këshillit të Ministrave u miratua krijimi, organizimi dhe funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR). Misioni i AKR-së është garantimi i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të të rinjve, nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë. [Lexoni më shumë rreth vendimit](#)

Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian zhvilloi mbledhjen e radhës



Më 24 shtator 2020, Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (KKIE) zhvilloi takimin e radhës virtual për progresin e realizuar dhe sfidat në kuadër të kriterit politik dhe kapitullit 23 'Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut', me fokusin në 15 pikat e vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 mars 2020 për hapjen e negociatave.


Takimin e përshëndetën Kryetarja dhe Nënkryetari i Këshillit, Znj. Rudina Hajdari dhe Z. Taulant Balla. Për të informuar anëtarët dhe të ftuarit e KKIE-së lidhur me progresin e bërë në kuadër të kapitullit 23 dhe sfidat e së ardhmes ishte e ftuar ministria e Drejtësisë, Znj. Etilda Gjonaj.

Pas prezantimeve mbi temën e takimit, vijuan diskutimet, komentet dhe sugjerimet nga drejtuesit e institucioneve të pavarura dhe anëtarë të Këshillit Kombëtar të Integritimit. Pjesë e diskutimeve të tryezës u bënë edhe Znj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit; Znj. Ilda Zhulali, këshilltare e Presidencës së Republikës dhe Znj. Erida Skëndaj nga Komiteti i Helsinkit e cila në fjalën e saj mes të tjerash adresoi në Këshill shqetësimin për projektligjin e ri për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, në emër të grupimit të organizatave që kanë reaguar për këtë çështje. "Edhe pse në afatë të ngushta kohore, organizatat e shoqërisë civile u përfshinë në procesin e konsultimit të zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë, por deri më tani, nuk kemi asnjë reagim zyrtar, për reflektimin e komenteve dhe sugjerimeve tona, veçanërisht ato parimore. Tashmë procesi është kanalizuar në procedurë parlamentare ndaj shpresojmë që konsultimi i këtij projekti nga organet përgjegjëse parlamentare të jetë efektiv dhe i arsyeshëm në aspektin kohor".



Znj. Vasilika Hysi, nënkryetare e Kuvendit, në fjalën e saj u ndal edhe në rëndësinë e disa mekanizmave të tjerë në Kuvend, përgjegjës për shqyrtimin e rekomandimeve të bëra për hapjen e negociatave dhe monitorimin e ecurisë së tyre. [Lexoni më shumë rreth takimit](#)

Takim për koordinim e rritje të bashkëpunimit mes TACSO 3 dhe Qendrave Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi



Në muajin shtator u organizua takimi i dytë virtual për shkëmbim informacioni dhe koordinim të punës mes Programit TACSO 3 dhe Qendrave Kombëtare Burimore të Shoqërisë Civile në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, të dyja programe këto mbështetur nga Bashkimi Evropian.

Në takim morën pjesë 22 përfaqësues të OSHC-ve që shërbejnë si Qendra Burimore për shoqërinë civile në këto vende, përfaqësues të Delegacioneve të BE, përfaqësues të lartë nga DG NEAR dhe ekipi i TACSO 3.

Si pjesë e takimit u diskutua mbi aktivitetet në vijim të Tacso 3 dhe Qendrave Burimore në vendet e rajonit, programin P2P, krijimin e databazës së të dhënave për projektet dhe nën grantet e Civil Society Facility (CSF) si dhe për rolin e Qendrave Burimore në

The CSF MIS will provide:

- Detailed quantitative analysis:
 - of projects/contracts across single of a range of geographies
 - of grants and second level contracting/financial support to Third Parties (FSTP)/sub-grants including types, sizes, locations
- Communication approaches with grantees
- Monitoring of the implementation of the CSF
- Aggregation of information
- A facilitated reporting process

Session 1 – Capacity Development and P2P Program- NRCs needs

Needs:

- Support through P2P in organizing events such as public benefit status.
- Support for national level discussion on important issues such as CSO standards, sustainability issues, cooperation to other sector, role of CSOs in regard to EU integration, taxation.
- CS in resilience concept, solidarity and partnership, public performance.
- Expert provision.

zhvillimin dhe konsultimit për Udhëzuesin për mbështetjen e BE-së ndaj shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2021-2027. [Lexo më shumë](#)

UNITED NATIONS DEMOCRACY FUND

Home > About UNDF > Projects > News > Evaluations > Applying for Funding > Information for Grantees > Donors > Lessons > Contact UNDF

Home > Applying for Funding > Guidelines

Apply for Funding

Guidelines for applicants

Please download the useful linked documents below to aid in your preparations to apply for funding:
[Click here to read UNDF's Project Proposal Guidelines in English \(PDF\)](#)
[Click here to download UNDF's Blank Project Proposal Form in English \(PDF\)](#)

Veuillez télécharger les documents utiles ci-dessous pour aider à préparer votre demande de financement:
[Cliquez ici pour consulter le guide de soumission de projet du FNUD en français \(PDF\)](#)
[Cliquez ici pour télécharger le formulaire de proposition de projet en français \(PDF\)](#)

Technical support

We advise all applicants to submit well before the final few days of the call as the system becomes overloaded as a result of heavy use resulting in some applicants failing to submit on time.
 For technical support please email info@undfdemocracy.org

Apply for Funding Here
Postulez pour un financement ici

- Apply for Funding
- Tips and Lessons Learned for Applicants
- FAQs

hapur

BE EUROPEAN UNION CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME

The 3rd Call for Proposals under the IPA Cross-border Cooperation Programme between the Republic of North Macedonia and Albania 2014-2020

hapur

NOW OPENED

Fourth RYCO Open Call

We are looking for ideas to change the Western Balkans

mbyllur

hapur

THIRRJE PER PROJEKTE STRATEGJIKE

AFATI I APLIKIMIT: 7 GUSHT 7 SHTATOR

WWW.LEVIZALBANIA.AL

mbyllur

THIRRJE PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR DORËZIMIN E PROJEKT PROPORIZIME NË PF "KUJDESIA SOCIAL PËR FAMILJET DHE FEMIJET"

mbyllur

CALL FOR PROPOSALS

hapur

CALL FOR PROPOSALS

Support to local self-governments and/or CSOs to fight discrimination and foster inclusion

Horizontal Facility for the Western Balkans and Turkey 2019-2020

Action "Promotion of diversity and equality in Albania"

mbyllur

CALL FOR EVALUATORS

for Regional Grants Applications

Deadline: 11 September 2020

Apply on: regionalhub@balkancsd.net

mbyllur

BALKAN GREEN IDEAS

mbyllur

THIRRJA PER APLIKIME

15 SHKURT 2020 ME 5 GUSHT 2020, ORA 23:59

APLIKONI VETËM ONLINE NË WWW.LEVIZALBANIA.AL

mbyllur

APPLY NOW

CALL FOR PROPOSALS

for Regional Multi-Country Action Grants

Deadline: 15 September 2020

mbyllur

13 SEPTEMBER DEADLINE

\$140,000 in grants for earthquake relief

CALL FOR PROPOSALS

mbyllur

WEICG

APPLY NOW: Call for CSOs interested in PAR monitoring

mbyllur

THIRRJE DHE MUNDËSI

KALENDAR TREMUJOR

Shënoni në kalendarin tuaj! Përfshihu në aktivitetet tona të ardhshme!

Tetor 2020						
S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

Nëntor 2020						
S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30					

Dhjetor 2020						
S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			



Akademia e OJF-ve



Trajime dhe Seminare për OShC-të



Aktivitete rrjetëzimi



Forume Publike dhe Evente

TAKIME E KONFERENCA



Partnerët Shqipëri disponon pranë zyrave të saj, një sallë 45 m2, të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e eventeve të ndryshme si trajnime, takime pune, konferenca etj.

Përparësitë:

Sallë e përshtatshme me ndriçim natyral, pajisje bashkëkohore, kondicionim etj.

Vendndodhje shumë e mirë

Çmim konkurrues

Mundësi rrjetëzimi dhe ekspozimi

Mundësi për webinarë, trajnime e konferenca e online, deri në 25 pjesëmarrës


Ju mirëpresim!

Për më shumë informacion lutemi lexoni broshurën më poshtë. Për të rezervuar në kontaktoni në:


Cel: 00355 697889600
Tel. 00355 4 2254881
partners@partnersalbania.org




Cocktail
(standing)



Classroom



Theatre



Round
Table

CONTACT US :

Zyra në Tiranë

Rruga e Elbasanit, PARK GATE, Kati i 10të, Ap. 73, Tiranë

(në mjediset e "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim")
Tel/Fax: +355 4 2254881

E-mail: info@resourcecentre.al

Zyra në Shkodër

Rr. Studenti, Sheshi Democracia, Kati 7, Pallati pranë Radio Shkodes

(në mjediset e Shoqatës "Gruaja në Zhvillim")

E-mail: shkodra@resourcecentre.al

Zyra në Vlorë

Lagjja 29 Nëntori, Rr. Dede Ahmet Amataj, Çerdhja 15, Kati i 2të, Vlorë

(në mjediset e Qendrës "Aulona")
Tel: +355 3 3224531" Center)

Tel: +355 3 3224531

E-mail: vlora@resourcecentre.al

FOLLOW



@[resourcecentre.al](https://www.facebook.com/resourcecentre.al)



@[resourcecentrealbania](https://www.instagram.com/resourcecentrealbania)



@[resourceCSO_al](https://twitter.com/resourceCSO_al)



@[ResourceCentreAlbania](https://www.youtube.com/ResourceCentreAlbania)



@<http://www.resourcecentre.al/>